



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT**

**MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE AND TECHNOLOGY**

Udhëzim Administrativ

Lënda : Fillimi i vitit shkollor 2002/03

Nr: MASHT 10/2002

Datë: 20 Gusht 2002

Në përputhje me Rregulloren Nr.2001/19 , të datës 13 shtator 2001, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë.
Në përputhje me Ligjin për Arsimin fillor dhe të mesëm, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës(në pritje të shpalljes)

Ministria e Arsimit Shkencës dhe e Teknologjisë , nxjerr këtë:

Udhëzim Administrativ

Neni 1

Qëllimi

- Ky udhëzim Administrativ ka për qëllim, që t'i udhëzojë strukturat arsimore (zyrtarët e Ministrisë,zyrtarët e lartë, drejtorët e shkollave ,nxënësit ,prindërit dhe të tjerët), që të kenë lehtësi për fillimin me sukses të vitit të ri shkollor 2002/2003.

Neni 2

Programet arsimore

- Në këtë vit shkollor 2002/2003, shkolla fillore (8 klasëshe) do të punojë me programet ekzistuese.Shkollës fillore i është shtuar klasa 9(nëntë) orientuese kalimtare e cila do të punojë në lokalet e shkollës së mesme.

- Programet mësimore të vitit I (parë) të arsimit të mesëm , pushojnë së ekzistuari në të gjitha shkollat e përgjithshme , profesionale dhe artistike .

Neni 3

Regjistrimi i nxënësve

- Nxënësit e klasës I (parë) të shkollës fillore , regjistrohen sipas planit të regjistrimit të muajit qershor.
- Nxënësit të cilët kanë mbaruar shkollën fillore tetëklasëshe ndjekin mësimin në lokalet e shkollës së mesme , në klasën e 9 (nëntë) ,të cilën e cakton Drejtoria Komunale e Arsimit me pëlqimin e zyrtarve të lartë të arsimit.

Neni 4

Nxënësit përsëritës

- Për nxënës të cilët e kanë përsëritur klasën e I (parë) të shkollës së mesme në vitin shkollor 2001/2002, shkolla është e obliguar të organizojë provimet e klasës në afatin e gushtit (i cili duhet të organizohet më së voni deri më 15 shtator 2002), si dhe afatin e januarit ,ndërsa, në ndërkohë ,këta nxënës vijojnë mësimet e klasës II (dytë) si dëgjues.
- Nxënësit të cilët nuk e kryejnë me sukses klasën e I (parë) në afatet e përmendura humbin statusin e nxënësit në atë shkollë , dhe mund të konkurrojnë në profilet arsimore ,sikurse nxënësit tjerë në vitin shkollor 2003/2004, për klasën e X (dhjetë)

Neni 5

Lokali shkollor

- Lokali shkollor në të cilën vijojnë mësimin nxënësit e klasës 9 (nëntë) orientuese , dhe nxënësit e shkollave të mesme (klasët II,III,IV), përcaktohet nga drejtoritë komunale të arsimit në bashkpunim me MASHT,përmes Zyrtarëve të Lartë të Arsimit.
- Nxënësit e klasës 9 (nëntë), në rastet kur kjo është e mundshme ,duhet të vendosennë një ose dy qendra shkollore .Në rast të kontestimeve të mundëshme , vendimin përfundimtar e merr MASHT-i

Neni 6

Udhëheqja dhe Administrimi

- Vendosja e nxënësve të klasës 9 (nëntë) orientuese, si dhe nxënësve të klasëve (II,III,IV) të arsimit të mesëm në ndërtesa të ndryshme shkollore nuk e ndryshon statusin e shkollave ,strukturën e tyre ,vitin shkollor 2002/2003 (deri në përcaktimin e rrjetit të ri të shkollave të mesme të larta)
- Udhëheqja dhe administrimi i shkollave nuk ndryshon pavarsisht, nga lëvizjet e nxënësve dhe të arsimtarëve në objekte të tjera shkollore.

Neni 7

Dokumentacioni i nxënësve

- Drejtorët e shkollave fillore janë të obliguar që të përgadisin listat e nxënësve të klasëve të 8 (teta) sipas paraleleve dhe numrit të nxënësve dhe listat përkatëse t'ua dorëzojnë drejtorive komunale të arsimit më së voni deri me 24.08.2002.
- Drejtoritë komunale të arsimit janë të obliguara që një kopje të nxënësve të klasëve të 8 (tetë) t'ua dorëzojnë drejtorëve të shkollave ku do të vendosen këta nxënës dhe një kopje Zyrtarit të Lartë të Arsimit.
- Drejtorët e shkollave fillore janë obliguara ti plotësojnë dëftesat e nxënësve të klasëve të 8 (tetë) dhe ato me shkrim t'ua dorëzojnë drejtorëve të shkollave ku nxënësit do të vijojnë klasën e 9 (nëntë) orientuese më së voni deri me 10 shtator 2002.
- Nxënësit të cilët dëshirojnë të vazhdojnë shkollimin jashtë Kosovës mund t'i tërheqin dëftesat e klasës 8 (tetë) nga drejtori i shkollës përkatëse dhe nxënësit të cilët nuk regjistrohen në shkollat publike.

Neni 8

Përzgjedhja dhe agazhimi i kuadrit

- Drejtorit komunale të arsimit në bashkëpunim me zyrtarët e lartë të arsimit si dhe me drejtorët e shkollave të mesme janë të obliguar që të bashkëpunojnë për përzgjedhjen e kuadrit mësimorë në cdo shkollë .Në rast të kontestimeve të ndyshme vendimin përfundimtar e merr MASHT-i
- Për zbatimin e planit dhe programit mësimor për klasën e 9 (nëntë) do të angazhohen arsimtarët e shkollave të mesme .
- Për arsimtarët e kualifikuar të cilët kanë pasur kontrata të vlefshme në vitin shkollor moslargimit të tyre nga sistemi i pagesave dhe për ta do të ofrojë një program trajnimi për klasën e X (dhjetë)
- Arsimtarët të cilët refuzojnë angazhimin e tyre për të dhënë mësimin në klasën e 9 (nëntë) iu shkëput kontrata e punës me MASHT-in

Neni 9

Aftësimi i arsimtarëve

- Të gjithë arsimtarët të cilët do të angazhohen për zbatimin e planit dhe programit në klasën e nëntë ,janë të obliguar që të vijojnë seminarin sipas programit të përcaktuar nga MASHT-i
- Aftësimi i arsimtarëve do të vazhdojë edhe me programe të tjera , të cilat , mund të organizohen gjatë vitit shkollorë 2002/2003

Neni 10

Plani dhe programi i klasës së 9 (nëntë)

- Plani dhe programi mësimor për klasën e 9 (nëntë) orientuese, është shtypur në 3000 eksemplarë (për zyrtarët e MASHT, zyrtarët e lartë të arsimit , drejtorët komunal të arsimit ,drejtorët e shkollave dhe të gjithë arsimtarët

- Drejtorët e shkollave janë të obliguar që nëse arsimtarët i shmangen kurrikulit të lëndës në orët e mësimit apo largohen nga shkolla të marrin (tërheqin) planin dhe programin e klasës së 9 (nëntë) orientuese’
- Drejtorët e shkollave janë të obliguar të mbajë evidencë me shkrim për numrin e ekzemplarëve të planit dhe programit përkatëse.

Neni 11

Perjashtim

- Për shkollat me mësim në gjuhën serbe , ky Udhëzim Administrativ do të zbatohet në vitin shkollor 2003/2004.

Neni 12

Financimi

- Drejtorët komunal të arsimit përmes zyrtarëve ndërkombtarë regjional të arsimit dhe administratorit ndërkombtarë të komunës duhet ta konstatojë buxhetin e tyre për shërbime dhe mallëra dhe për shpenzime kapitale në mënyrë që të përgadisnin një program financiar për shfrytëzimin e atyre mjeteve në veçanti për klasën e nëntë (për adaptim të lokalit, pajisje kabinetike , inventar e shpenzime e tjera).

Neni 13

Hyrja në fuqi

- Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me 20 gusht 2002

-

Rexhep Osmani
Ministër